



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 247, datë 04.11.2019

PËR
NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 112, DATË 09.07.2019
TË KËSHILLIT TE LARTË GJYQËSOR

Në mbështetje të neneve 14 dhe 33 të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, pikën 1 të Vendimit nr. 112, dt 09.07.2019 të KLGJ, “Për Praktikën Profesionale të Kandidatëve për Magjistratë të Shkollës së Magjistraturës për Periudhën Korrik 2019- Qershor 2020”, mbi kërkesën, informacionin dhe materialet e dërguara nga Shkolla e Magjistraturës, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I :

1. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...} , e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, z. {...}, për periudhën Mars 2020- Qershor 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...} .
2. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, zj. {...}, për periudhën Nëntor 2019 - Shkurt 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. {...}.
3. Të zëvendësojë magjistratin gjyqtar udhëheqës, znj. {...}, e caktuar për kandidatin për magjistrat, profili gjyqtar, znj. {...}, për periudhën Mars 2020 - Qershor 2020, me magjistratin gjyqtar udhëheqës, z. {...}.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR